



Republika e Kosovës/Republika Kosova/ Republic of Kosova
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova /Government of Kosova

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for
Agricultural Development

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL			
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA			
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT			
AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË-AGENCIJA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ			
AGENCY FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT			
Organizimi: Org. Indek. Org. Dant.	07/4	Nr. Prot. Sr. Prot. Prot. No.	397/2
Nr. i dokumentit Bioplatonika No. pages:	57	Data Datum Date	16.02.2017
PRISHTINE/A			

PLANI OPERACIONAL I PUNËS 2017

AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË



Prishtinë



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development

Përmbajtja

Lista e tabelave	3
Lista e Figurave.....	3
Akronimet (Shkurtesat)	4
HYRJE.....	5
I. DIVIZIONI I ADMINISTRATES SË PËRGJITHSHME	7
Sektori i personelit	7
Sektori i Logjistikës.....	12
Sektori Juridik.....	14
Sektori i menaxhimit të dokumentacionit (Arkiva)	14
II. DIVIZIONI I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL	16
Objektivat e përgjithshme të PZHR.....	16
MASA 101.....	17
MASA 103.....	17
MASA 302.....	18
MASA - Ujitja e tokave bujqësore	18
MASA 303.....	19
Aktivitete tjera shtesë që do të realizohen gjatë vitit 2017.....	22
Trajnimi i stafit të DMPZHR.....	22
III. DIVIZIONI I AUTORIZIMIT TË PAGESAVE.....	23
Plani aksional i zhvillimit të aktiviteteve të Autorizimit të Pagesave	24
Pranimi i Kërkesave për Pagesë	24
Trajnimi i stafit të DAP	28
IV. DIVIZIONI I PAGESAVE DIREKTE	29
Objektivat e divizionit të pagesave direkte per vitin 2017	29
Pagesat direkte per sipërfaqe.....	31
Pagesat direkte ne blegtori.....	33
Pagesat direkte - Material fidanor dhe Akuakulture	34



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

V. DIVIZIONI I KONTROLLIT NË TEREN.....	35
VI. DIVIZIONI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE REGJISTRAVE.....	42
Regjistri Elektronik i Fermëve (eFR)	46
Softueri për Menaxhimin e Pagesave Direkte.....	49
Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS)	50
sLPIS-Mobile	53
Softueri Grant Menaxhment.....	54

Lista e tabelave

Table 1. Buxheti për të gjitha Masat e Projekteve të Zhvillimit Rural 2017	19
Table 2. Buxheti për të gjitha Masat e PD - 2017.....	30
Table 3. . Plani i implementimit i kontrollit.....	41
Table 4. Plani i Implementimit për Divizionin e TI & Regjistrave	56

Lista e Figurave

Figura 1. Organogrami i AZHB-së 2016	8
Figura 2. Organogrami i AZHB-së 2017	10
Figura 3. Lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) që do të funksionojë gjatë vitit 2017	44
Figura 4. Sistemi i komunikimit të AZHB-së	45
Figura 5. Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR gjatë vitit 2017.....	48
Figura 6. Lidhja e LPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit.....	51
Figura 7. Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS).....	52
Figura 8. Skemë si funksion LPIS-it dhe LPIS-MOBILE.....	53



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Akronimet (Shkurtesat)

AZHB - Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë
MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
AM - Autoriteti Menaxhues
BB - Banka Botërore
BE - Bashkimi Europian
DAP - Departamenti i Administratës së Përgjithshme
PZHR - Projektet e Zhvillimit Rural
PD - Pagesat Direkte
AP- Autorizimi i Pagesave
TI - Teknologjia e Informacionit
ZK - Zyra e kontrollit
ZR - Zyret Regjionale
LPIS - Sistemit të Integruar të Manaxhimit dhe Identifikimit të Parcelave
MF SIMFK - Ministria e Financave, Sistemi i Menaxhimit të Financave Kosovë
APK - Agjencia e Pyjeve të Kosovës
AUK - Agjencia e Ushqimit të Kosovës
OE - Operatoret Ekonomik
U/A - Udhëzues Administrativ
PZHR - Projektet e Zhvillimit Rural
DAPZHR - Divizioni i Autorizimit të Pagesave për Projektet e Zhvillimit Rural
eFR - Regjistri Elektronik e Fermerëve
NIF - Numri Identifikues i Fermës



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

HYRJE

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është themeluar me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nr. 04/L-090 për ndryshim plotësimin e Ligjit me nr. 03/L-98 si Agjenci Ekzekutive në kuader të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Rregullorës 01/2012 për Detyrat, Përgjegjësit, Kompetencat dhe strukturën Organizative të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe është përgjegjëse për implementimin e programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke zbatuar rregulloret dhe procedurat e shkruara për implementimin e Pagesave Direkte dhe Projekteve për Zhvillim Rural.

Organizimi i AZHB është përcaktuar me U/A 01/2012 i cili U/A, gjatë vitit 2015/16 është rishikuar, plotësuar duke u bazuar në kërkesat e IPARD II me asistenc të projektit Agroconsolting i financuar nga KE. Sipas rregullorës së re AZHB do të funksionalizohet sipas këtyre kriterëve dhe do të ketë zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm dhe tetë Drejtori si dhe sektorin e Auditimit të Brendshëm dhe Sektorin e Kontrollit të Brendshëm në vartësi direkte të zyrës së drejtorit të përgjithshëm.

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë me organizim të ri sipas Rregullorës së re do të mundësoi krijimin e kushteve për zbatimin e procedurave të IPARD II, do të sigurohet hapsirë, pajisje, Logjistik dhe TI për menaxhim sa më të mirë të buxhetit të planifikuar për mbështetje nga buxheti nacional dhe donatorët. Ky angazhim do të përfshin zgjerimin e programeve në të ardhmen, standardizimin e procedurave si dhe zhvillimet e reja në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë si ngritjen profesionale të stafit për mes trajnimeve për të arritur standardet në nivelin e dëshirueshëm të BE-së. Krijimi i Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë sipas kriterëve të komponentës IPARD do të rrisë sigurinë në menaxhimin e buxhetit nacional dhe mjeteve të projektit të Bankës Botërore dhe në një të ardhme shumë të afërt do të mundësoi rritjen e besueshmërisë për menaxhimin edhe të mjeteve financiare të BE dhe donatorëve tjerë.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Objektiv i AZHB edhe këtë vit do të jetë zbatimi i suksesshëm i programeve për mbeshtetje përmes Granteve Investive dhe Pagesave Direkte me qëllim të rritjes së të ardhurave në fermë, rritja e konkurrueshmërisë së fermerëve në tregun rajonal, të BE dhe atë nderkombëtar, ngritja e standardit të prodhimeve bujqësore për siguri dhe higjienë si dhe ngritja e mirëqenies së kafshve në fermë. Një objektiv i rëndësishëm i mbeshtetjes përmes skemave të mbeshtetjes financiare do të jetë edhe modernizimi i teknologjisë së prodhimit dhe orientimi komercial i fermave tona me qëllim të plotësimit të nevojave të konsumatorëve për prodhime bujqësore.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

I. DIVIZIONI I ADMINISTRATES SË PËRGJITHSHME

Administrata e Përgjithshme në kuadër të kompetencave sipas përshkrimit të detyrave të punës do të zhvilloi aktivitetet e planifikuara për menaxhimin e buxhetit, personelit, logjistikës, çështjeve ligjore, arkivimit dhe menaxhimi i zyrës së pranimit.

Divizioni i Administratës së Përgjithshme ende i pa plotësuar sipas organogramit dhe rregullorës për organizimin e brendshëm do të fokusohet në aktivitete për plotësimin e vendeve të pa plotësuara e të parapara me rregullore edhe pse nuk ka buxhet të mjaftuar për plotësimin e tyre.

Stafi aktual i DAP do të zhvilloi aktivitetet e planifikuara duke angazhuar stafin ekzistues për mbulimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara deri në plotësimin me staf adekuat.

Momentalisht në DAP janë aktivë tre sektor (sektori juridik, sektori i logjistikës dhe sektori i menaxhimit të dokumentacionit) me stafë të kufizuar kurse sektorët tjerë mbulohen nga zyrtarët ekzistues për ofrimin e informacioneve të nevojshme për MBPZHR dhe institucione tjera. Nje pjesë e aktiviteteve në përgjegjësi të DAP pran AZHB-së do të vazhdojnë të kryhen nga drejtoritë- divizionet përkatëse të MBPZHR-së (qështjet financiare, procedurat e prokurimit, menaxhimi i procedurave për rekrutim etj) deri në plotësimin e stafit në AZHB.

AZHB do të riperseris kërkesën për buxhet shtesë dhe staf edhe gjatë rishikimit të buxhetit për të marrë përgjegjësitë që i takojnë sipas ligjit dhe rregullores se brendshme.

Sektori i personelit

Sektori i personelit në AZHB është duke u mbuluar nga zyrtari i lartë për logjistikë me qëllim të mbajtjes së evidencave të vijueshmerisë, hartimit të planeve të punësimit, planeve të trajnimeve, planeve të pushimeve vjetore dhe evidenca tjera të domosdoshme për zhvillimin e aktiviteteve.



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

Planifikimi i nevojave dhe përgatitja e kërkesave për sigurimin e buxhetit për staf të AZHB-së sipas kërkesave të divizioneve bazuar në rregullorën e brendshme të organizimit të AZHB-së, kritereve të IPARD II dhe kërkesave për akreditim do të përseritet gjatë afatit për rishikim të buxhetit. Sipas rregullorës së brendshme të AZHB-së për mbulimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara nevoitën 121 të punësuar të përhershëm.

AZHB gjatë vitit 2016 ka funksionuar sipas këtij organogrami;




Figura 1. Organogrami i AZHB-së 2016



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

AZHB edhe për vitin 2017 ka bërë kërkesë për buxhet shtesë për rekrutimin e stafit të nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara por nuk është miratuar, andaj do të vazhdohet me parashtrimin e kërkesave në institucionet tona po edhe tek donatorët për plotësimin e nevojave për stafë për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara.

Janë realizuar kërkesat tona për rekrutimin e 19 zyrtarëve nga BB dhe dy zyrtarëve nga buxheti i MBPZHR-së gjegjësisht AZHB-së me kontrata afatëshkurta.

Do të zhvillohen procedurat e rekrutimit për 10 zyrtarë tjerë me qëllim të themelimit të Divizionit të Financave, Auditorit të Brendshëm dhe fuqizimi i divizioneve ekzistuese me stafë me zyrtarë të nevojshëm.

Pjesë e aktiviteteve të DAP-it do të jenë aktivitetet për implementimin e rregullores së brendshme të AZHB-së për ngritjen e nivelit të divizioneve në drejtori, emërimin e drejtoreshave dhe implementimin në tersi të organogramit.

AZHB bazuar në propozim rregullorë të re dhe skemën e organizimit do të ketë këtë strukturë organizative:



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development




Figura 2. Organogrami i AZHB-së 2017

Të gjitha këto kërkesa dhe aktivitete janë të domosdoshme duke marr për bazë rritjen e numrit të skemave të mbështetjes për PD dhe PZHR (vlerësim mbi 45,000 aplikacione), si dhe rritja e buxhetit për grante dhe subvencione, (qershor – korrik 2017).

Aktivitetet specifike të sektorit të personelit:

- ✓ Hartimi dhe monitorimi i planit të trajnimeve të stafit të AZHB-së sipas nevojës dhe propozimeve të divizioneve përkatëse dhe monitorimi i zbatimit te tyre.
- ✓ Përmbledhja e kërkesave të Divizioneve për nevojat për trajnim dhe kujdesi për sigurimin e kushteve për organizimin e këtyre trajnimeve në bashkëpunim me divizionet përkatëse dhe sektorin e logjistikës (përmanent gjatë vitit 2017).



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

- ✓ Hartimi i planit dhe mirëmbajtja e evidencave të shfrytëzimit të pushimit vjetor, dhe formave të tjera të pushimeve për zyrtarët e AZHB-së. Në fillim të vitit 2017 do të hartohet plani i pushimeve vjetore për të punësuarit e AZHB-së nga të gjitha divizionet dhe plani i përgjithshëm nga DAP do të plotësohen të gjitha kërkesat për pushim dhe do të mirëmbahet evidenca e shfrytëzimit të pushimeve vjetore (përmanent gjatë vitit 2017).
- ✓ Monitorimi i vijueshmërisë në punë dhe përgatitja e raporteve mujore të vijueshmërisë. Do të mbahet evidenca ditore e vijueshmërisë së punëtorëve, si në qendër dhe në zyrat regjionale të AZHBsë.

Me përfundimin e muajit do të grumbullohen të dhënat nga ZR të AZHB-së dhe do të përpilohet raporti i përgjithshëm mujor i vijueshmërisë i cili procedohet në personelin e MBPZHR-së.

Kontrolli periodik i vijueshmërisë për të gjithë punëtorët duke përfshirë edhe punëtorët në zyrat regjionale (në baza ditore, mujore etj).

- ✓ Evidentimi dhe kalkulimi i orëve shtesë dhe punës jashtë orarit për stafin e AZHB-së (përmanent gjatë vitit 2017) dhe parashtrimi i kërkesave për kompenzim në rast se ka mundësi buxhetore.
- ✓ Zhvillimi i procedurave disiplinore (sipas nevojës).
- ✓ Monitorimi, azhurnimi i vazhduar i kontratave të sherbyesve civil të angazhuar nga BB dhe stafit me Kontratë për Shërbime të Veçanta, si dhe vendimet për ndryshime eventuale të vendeve të punës për të punësuarit e AZHB-së të financuara nga buxheti apo donatorët.
- ✓ Përgatitja e formularëve të vijueshmërisë dhe faturave për stafin e angazhuar nga BB si dhe aktivitete tjera nga fushëveprimi i menaxhimit të personelit.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Sektori i Logjistikës

- ✓ Ofrimi i kushteve sa ma të mira të punës për stafin e AZHB (sigurimi i hapësirës optimale, inventar, pajisje të TI dhe material për zyrë). Do të zhvillohen aktivitete për sigurimin e hapësirës optimale për të punësuarit në AZHB në qendër dhe në zyrat regjionale.

Gjatë këtij viti do të punohet për sigurimin e lokacionit për ndertimin e objektit të ri të AZHB-së pasi janë siguruar një shumë e mjeteve financiare, kurse pjesa tjetër do të sigurohet nga donatorët,

Ne buxhetin për vitin 2017 janë planifikuar mjete financiare për ndërtimin e objektit të ri, do të zhvillohen procedurat për sigurimin e lokacionit, lejes së ndërtimit dhe fillimi i procedurave për ndërtimin e objektit me një hapësirë prej 2000- 3000 m².

Gjithashtu gjatë këtij viti do të ndermeren aktivitete për sigurimin e hapësirave optimale për zyrat regjionale të AZHB e sidomos asaj në Prishtinë dhe Gjakovë si dhe aktivitete për renovim aty ku ka nevojë.

- ✓ Planifikimi i nevojave të AZHB-së për inventar, TI dhe material për zyrë, konform rritjes së numrit të stafit në zyrat qendrore dhe në zyrat regjionale.

Hartimi i planit për furnizim me material për zyra për nevojat e AZHB-së (shkurt 2017).

Kërkesat për furnizim me material për zyra do të bëhet çdo tremujor të vitit 2017.

Në bashkëpunim me Divizionin e TI do të hartohet nevojat për mirëmbajtjen dhe furnizim me pajisje të TI.

- ✓ Monitorimi i shfrytëzimit dhe shpenzimeve të automjeteve në AZHB. Aktivitetet e planifikuara të AZHB-së e sidomos kontrollin në vendngjarje, shtimi i numrit të inspektorëve në zyrat regjionale shtojnë nevojën për logjistik të konsiderueshme e sidomos vetura dhe pajisje tjera për realizimin e kontrollit ne teren, këtë vit do të ketë furnizim me vetura te reja për AZHB-në (gjithësejt 6).



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Këto furnizime me logjistikë do ta amortizojnë kërkesën për logjistikë nga se të gjitha zyrat regjionale të AZHB-së do të kenë në dispozicion nga tri vetura në gjendje të mire për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë vitit 2017, nëse realizohen këto furnizime do të ndermerrën veprime për largimin nga perdorimi i veturave të amortizuara të cilat kanë kosto të lartë të mirembajtjes.

- ✓ Mbikëqyrja e shfrytëzimit të automjeteve dhe përgatitja e raporteve mujore dhe periodike të shpenzimeve (në baza mujore dhe periodike dhe vjetore gjatë vitit 2017).
- ✓ Monitorimi i shpenzimeve të qerasë, mirëmbajtjes së objektit, sigurimin e objektit, komunalive, shpenzimeve të energjisë dhe furnizimeve të tjera për nevoja të AZHB-së në zyrën qendrore dhe zyrat regjionale, duke përgatitur kërkesat për egzekutimin e pagesave (në baza mujore gjatë vitit 2017).
- ✓ Angazhime për sigurimin e hapsirës ma të madhe për arkiv të AZHB, ruajtja e dosjeve bazuar në Ligjin e Arkivave.
- ✓ Sigurimi i hapsirës shtesë për arkivimin e dokumentacionit të AZHB-së në depon e MBPZHR-së ose ndonje objekt tjetër.
- ✓ Monitorimi i kontratave me OE të cilat ofrojnë sherbime për AZHB-në, afatet e kontratave, aktivitetet e kontraktuara, cilësin e sherbimeve të ofruara duke përgatitur raporte mujore dhe periodike.
- ✓ Parashtrimi i kërkesave për procedura prokuruese për furnizime, sherbime etj.
- ✓ Zhvillimi edhe i aktiviteteve të tjera nga lëmi i logjistikës të cilat mund të jenë të pa planifikuara.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Sektori Juridik

- ✓ Hartimi i planit legjislativ për vitin 2017 (dhjetor 2016),
- ✓ Parashtrimi i kërkesave për harmonizimin e ligjeve dhe rregulloreve për AZHB-në konform kërkesave të IPARD II, finalizimi i U/A për AZHB-në konform kërkesave të IPARD II (kuartali i parë i vitit 2017),
- ✓ Pjesmarrje në hartimin e Udhëzimeve Administrative për vitin 2017 për Pagesa Direkte dhe për Projektet e Zhvillimit Rural (janar - shkurt 2017),
- ✓ Kompletimi i AZHB-së me rregullore të nevojshme sipas kërkesave të pakos së akreditimit pazuar në IPARD II (plotësim ndryshimi i rregullores për funksionet e AZHB-së, rregullorës së brendshme lidhur me konfliktin e interesit etj.), (tremujori i dytë 2017),
- ✓ Monitorimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe procedurave të shkruara për vitin 2017 (pas përfundimit të miratimit),
- ✓ Informimi i stafit të AZHB-së me ligjet dhe rregulloret ekzistuese dhe ato të reja që ndërlidhen me punën në AZHB, (përmanent gjatë vitit 2017),
- ✓ Hartimi i kontratave, vendimeve dhe shkresave tjera sipas nevojës së AZHB-së (permanent gjatë vitit 2017),
- ✓ Menaxhimi i procesit të ankimimit në të dy shkallët e ankesave dhe procedurave për ngritjen e procedurave hetimore dhe gjyqësore për nevojat e AZHB-së (përmanent gjatë vitit 2017).

Sektori i menaxhimit të dokumentacionit (Arkiva)

- ✓ Bazuar në organogramin e ri dhe në pakon e akreditimit për AZHB pjesë e rëndësishme e DAP do të jetë sektori për menaxhimin e dokumentacionit. Ky sektor përveq menaxhimit të arkivit do të jetë përgjegjës edhe për qarkullimin e dokumentacionit brenda AZHB-së, zyrave regjionale dhe jashtë AZHB-së.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

- ✓ Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2016 është përgatitur softveri për menaxhimin e dokumentacionit i cili në tremujorin e dytë të vitit 2017 do të testohet. Ky softver do të shërbej për menaxhimin e qarkullimit të dokumentacionit në të gjitha fazat e implementimit të programeve, qarkullimi i dokumentacionit në drejtorit e AZHB-së dhe zyra regjionale duke përfshi edhe komunikimin me institucione të tjera.
- ✓ Sigurimi i hapsirës së nevojshme për arkivë, mirëmbajtja e dosjeve, mirëmbajtja e evidencave të hyrje daljes së dokumentacionit dhe shkresave.

Do të behet përpjekje për furnizim me pajisje të nevojshme (skaner) për nevoja të zyra regjionale dhe arkivë me qëllim të futjes në funksion të softverit për menaxhimin e dokumentacionit.

Divizioni i Administratës së Përgjithshme do të zhvilloi aktivitete permanente për funksionalizimin e të gjitha Drejtorive të parapara me rregullore sipas organogramit të ri të AZHB-së me qëllim të plotësimit të nevojave në stafë, logjistik e shërbime tjera në mënyrë që të sigurohen kushte sa më optimale për implementim të sukseshëm të programeve për mbeshtetje në bujqësi dhe zhvillim rural.

Fokus i aktiviteteve do të jetë sigurimi i lokacionit për ndërtimin e objektit, sigurimi i buxhetit shtesë për mallra dhe shërbime, plotësimi i të gjitha nevojave për stafë, rekrutimi i stafit për drejtoritë e pa formuara dhe ngritja e nivelit të divizioneve ekzistuese në drejtorit, ndarja e sektoreve sipas organogramit etj. Të gjitha këto aktivitete do të mundësojnë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi sipas rregullores së propozuar, parandalimin e konfliktit të interesit dhe zbatim të rregullave për implementimin e programeve.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

II. DIVIZIONI I MIRATIMIT TË PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT RURAL

Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural është kompetent për implementimin e Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe zbatimin e procedurave sipas Udhëzimit Administrativ 02/2017 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Bujqësia dhe Zhvillimi Rural janë një ndër sektorët kryesor të cilët kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Për këtë arsye mbështetja (përkrahja) për investimet në fermat/ekonomitë bujqësore është i një rëndësie vendimtare për të përmirësuar sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë për të arritur standarde më të larta të jetesës, përmirësimit të kualitetit të prodhimeve dhe përpunimeve të ndryshme bujqësore.

Objektivat e përgjithshme të PZHR

- ✓ Rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë kosovare dhe zëvendësimi i importit;
- ✓ Krijimi i vendeve të reja të punës dhe shtimi i punësimit në viset rurale;
- ✓ Përkrahja e fermerëve, në sektorët e përzgjedhur, me qëllim të përafrimit me rregullat, standardet, politikat dhe praktikat e BE-së;
- ✓ Përkrahja e zhvillimit ekonomik, social dhe territorial duke synuar rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet zhvillimit të kapitalit fizik;
- ✓ Adresimi i sfidave të ndryshimit klimatik përmes shfrytëzimit të energjisë së ripërtritshme.

Gjatë vitit 2017, Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural do të bëjë zbatimin e PZHR duke përfshirë Masat, nënmasat dhe sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR 2017 e që janë:



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

MASA 101

1. MASA 101 - “Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore” duke përfshirë sektorët:

- ✓ Sektori i pemëve drufrutore (molla, dardha, kumbulla, vishnje, qershija, kajsia, pjeshka, ftoni),
- ✓ Sektori pemë manore ,mjedra
- ✓ Sektori i pemëve manore (dredhëza, , manaferra , boronica, aronia),
- ✓ Sektori i perimeve (serra).
- ✓ Sektori depo për ruajtje të perimeve ,
- ✓ Sektori i mishit (trashja e viçave),
- ✓ Sektori i mishit (trashja e broilerëve),
- ✓ Sektori i mishit (trashja e derrave),
- ✓ Sektori i qumështit (lopë qumështore,,)
- ✓ Sektori i qumështit (dele dhe dhi),
- ✓ Sektori pikat grumbulluese të qumështit,
- ✓ Sektori i rrushit dhe
- ✓ Sektori i pulave vezëve.

MASA 103

2. MASA 103 - “Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe atyre të peshkatarisë” duke përfshirë:

- ✓ Sektori i përpunimit të qumështit,
- ✓ Sektori i përpunimit të mishit,
- ✓ Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve dhe
- ✓ Sektori i prodhimit të verës.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

MASA 302

3. MASA 302 - “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve” duke përfshirë:

- ✓ Sektori: Prodhimi, përpunimi dhe promovimi i mjaltit;
- ✓ Sektori: Grumbullimi, përpunimi dhe promovimi i prodhimeve jo drusore të malit.
- ✓ Sektori: Përpunimi dhe promovimi i prodhimeve bujqësore të kultivuara ;
- ✓ Sektori: Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve artizanale ;
- ✓ Sektori: Zhvillimi dhe promovimi turizmit rural.

MASA - Ujitja e tokave bujqësore



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development

MASA 303

MASA 303 - Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja Leader

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, gjegjësisht Divizioni për Miratim të Projekteve të Zhvillimit Rural gjatë vitit 2017 do të bëjë zbatimin e masave të lartpërmendura të Programit 2017 Buxheti i përgjithshëm i PZHR 2017

	Emri i masës	Buxheti ne euro
Masa 101	Investimet në assetet fizike të ekonomive bujqësore	14,500,000
Masa 103	Investimet në assetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore	5,000,000
Masa 302	Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve	1,500,000
Masa 303	Grupet lokale të veprimit (GLV)	300,000
Masa 501	Asistenca teknike	200,000
Masa UTB	Ujitja e tokave bujqësore	1,000,000
Masa KDFN	Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore	500,000
Totali		23,000,000

Table 1. Buxheti për të gjitha Masat e Projekteve të Zhvillimit Rural 2017

Aplikimi – Publikimi i thirrjes për aplikim është planifikuar prej datës 06.02.2017 dhe do të zgjasë deri me datën 20.03.2017 për Masat 101,103,302 dhe Ujitje të tokave bujqësore të parapara sipas Programit për Zhvillim Rural për vitin 2017. Së bashku me procesin e thirrjes për aplikim do të bëhet edhe distribuimi i materialit informues (Udhëzuesit për aplikant për Masën 101, 103, 302 dhe skema - Ujitja e tokave bujqësore,



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

si dhe fletëpalosjet dhe posterat për informatat shtesë mbi kriteret e përkrahjes për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017).

Aplikimi bëhet nëpër zyret regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan) dhe do të zgjasë 40 ditë nga data 06.02.2017 kur edhe do të përfundojë më 20.03.2017

Gjithashtu edhe të Masa 303,, **Zbatimi i strategjive Zhvillimore lokale qasja LEADER**” thirrja për aplikim do të publikohet në pjesën e parë të vitit 2017.

Gjatë procesit të aplikimit do të kontrollohet kompletimi i dokumentacioneve, dorëzimi i aplikacioneve dhe kontrolli i pranueshmërisë së aplikacioneve gjatë procesit bëhet regjistrimi i aplikacioneve në sistemin e menaxhimit të Granteve dhe kur të përfundoj procesi i aplikimit të gjitha dosjet e aplikuesve do të dorëzohen në zyret qendrore të AZHB-së në Divizionin e Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural me këtë edhe përfundon procesi i aplikimit.

Kontrolli administrativ, pas arritjes së dosjeve të aplikanteve në Divizionin e Miratimit të projekteve të zhvillimit rural do të vazhdojmë me kontrollin administrative kontrolli mbi kriteret e pranueshmërisë dhe vazhdimi i procesit të kriterëve të përzgjedhjes.

Kontrolli administrativ- Ka për qëllim që të verifikojë komplëshmërinë e dokumentacionit, pastaj kriteret e pranueshmërisë d.m.th verifikohet a janë aplikacionet e kompletuara sipas thirrjes për aplikim dhe kriterëve të pranueshmërisë dhe nëse aplikacionet i plotësojnë këto kritere vazhdojmë me procesin e vlerësimit (Poentimit) dhe kontrollës së parë në terren.

Kriteret e përzgjedhjes (Poentimit)- Të gjitha aplikacionet që i plotësojnë kriteret e pranueshmërisë gjatë kontrollit administrativë do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit në bazë të kriterëve të përcaktuara ku do të bëhet vlerësimi i projekteve dhe do të bëhet rangimi i tyre në baze të poentimit dhe kohës së aplikimit në mënyrë automatike në sistemin e Menaxhimit të Projekteve.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Publikimi i Listave të vlerësimit të aplikacioneve- Pas përfundimit të procesit të kontrollës administrative dhe vlerësimit të PZHR-së publikohen listat preliminare për të gjithë aplikuesit.

Autorizimi për kontrollen në terren - Pasi të kryhet procesi i vlerësimit duke u bazuar në numrin e pikeve të mbledhura sipas kriterëve të vlerësimit dhe buxhetit në dispozicion për sektorin e caktuar do të bëhet autorizimi i përfituesve të mundshëm për kontrollen e parë për të verifikuar kriteret e pranueshmërisë edhe në (terren) se a i plotëson kriteret fermeri për me qenë përfitues i mundshëm. Autorizohet lista e fermerëve përfitues të mundshëm dhe dosjet të dërgohen të Divizioni i Kontrollës të cilët e organizojnë kryerjen e këtij procesi.

Miratimi - refuzimi i PZHR 2017 - Pas përfundimit të kriterëve administrative, kriterëve të pranueshmërisë, kriterëve të vlerësimit dhe raportit të inspektorëve të kthyer nga terreni do të bëhet miratimi apo refuzimi i PZHR. Nëse bëhet refuzimi përpilohet vendimi për refuzim dhe i dërgohet fermerit për njoftimin e tij me shpjegimin e arsyeve për refuzim.

Nëse bëhet miratimi, atëherë përgatitet letra miratuese (ku specifikohen kushtet e implementimit) shpenzimet e pranueshme dhe koha e implementimit të projektit.

Periodha e kryerjes së këtyre aktiviteteve - Miratimi do të bëhet në periudhën sipas planit operacional që do të jetë mesi i muajit maj, në mënyrë kontinuele deri në përfundim të procesit që parashihet të jetë fundi i gushtit, me çka përfundon edhe procesi i miratimit për të gjitha Masat e parapara për përkrahje të PZHR 2017.

Nënshkrimi i kontratës dhe fillimi i investimit - Me nënshkrimin e kontratës në mes të AZHB-së dhe përfituesit të mundshëm do të përfundon procesi i përzgjedhjes së përfituesve të mundshëm dhe përcaktohet koha e kryerjes së investimeve për përfituesit e Projekteve të Zhvillimit Rural 2017.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Me këtë aktivitet përfundon edhe procesi i miratimit të PZHR dhe aktivitetet adresohen të divizioni i Autorizimit.

Aktivitete tjera shtesë që do të realizohen gjatë vitit 2017

Trajnimi i stafit të DMPZHR

Duke pasë parasysh se çdo vit ndërrojnë kriteret e implementimit të Masave të PZHR përseri do të bëhet trajnimi i zyrtarëve regional për procesin e aplikimit për PZHR para publikimit të thirrjes për aplikim, në mënyrë që zyrtarët të njohohen me procesin e aplikimit sidomos zyrtarëve të rinjë të cilët do të inkorporohen në këtë aktivitet.

Do të përgatitet sistemi i menaxhimit të granteve duke u bazuar në kriteret e realizimit të Projekteve.

Trajnimi i zyrtarëve të DPZHR (Zyret Regjionale të AZHB -së) mbi procedurat e aplikimit për PZHR 2016.

Vizitë studimore mbi procedurat e implementimit të Projekteve të Zhvillimit Rural sipas IPARD.

Të priturat

Do të bëhet realizimi i aktiviteteve dhe detyrave të cekura më lart, në mënyrë sa më të suksesëshme sipas planit dhe programit të paraparë dhe të arrihen objektivat e përgjithshme dhe specifike, do të rritet kualiteti i prodhimit në ferma prodhuese, përmirësimi i prodhimit në fermat përpunuese dhe rritja e sipërfaqeve të ngritura me pemë, perime, serra dhe kultura tjera të përfituesit e PZHR - si, do të përmirësohet higjiena në ferma, infrastruktura përcjellëse dhe standardet tjera minimale kombëtare që ndikojnë të arrihen objektivat e projekteve të mbështetura nga MBPZHR-AZHB. Po ashtu, që sa më shpejt t'i implementojmë rregullat apo standartet e BE-së sa i përket Projekteve të Zhvillimit Rural.

Të gjitha pikat e planifikuara të lartpërmendura do të realizohen me sukses dhe në afatet e parapara kohore, për ti arritur objektivat e parapara.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

III. DIVIZIONI I AUTORIZIMIT TË PAGESAVE

Divizioni i Autorizimit të Pagesave të Projekteve të Zhvillimit Rural është kompetent për autorizimin e pagesave sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe zbatimin e procedurave sipas Udhezimit Administrativ 02/2017 për masat dhe kriteret e përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Gjatë vitit 2017 nga Divizioni i Autorizimit të Pagesave të Projekteve të Zhvillimit Rural do të bëhet autorizimi i pagesave të PZHR – duke përfshir masat, nënmasat dhe sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR 2016 e që janë:

- 1. Masa 101 „Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore të gjitha sektoret**
- 2. Masa 302 „ Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale,, duke përfshir nënmasat**
- 3. Masa „Skema për Ujitjen e tokave bujqësore,,**
- 4. Masa 103 „Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore – kësti i dytë**
- 5. Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale qasja LEADER – këstin e dytë**

Gjithashtu gjatë vitit 2017 do të zhvillohen procedurat për Autorizimin e Pagesave për masat, nënmasat dhe sektorët e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që janë pjesë e PZHR 2017 e që janë:

- 1. Masa 101 „Investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore “**
- 2. Masa 103 „ Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe atyre të peshkatarisë**
- 3. Masa 302 „ Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve rurale,, duke përfshir nënmasat**
- 4. Masa „Skema për Ujitjen e tokave bujqësore,,**
- 5. Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale qasja LEADER**



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Plani aksional i zhvillimit të aktiviteteve të Autorizimit të Pagesave

Për autorizim të pagesave për projekte të zhvillimit rural për çdo përfitues prej momentit të kërkesave deri te autorizimi për pagesë duhet të kaloj nëpër disa hapa të një pasnjëshëm. Procesi fillon me kërkesën për pagesë e deri te ekzekutimi i pagesës nga financat. Hapat më të rëndësishëm në procesin e kërkesës për pagesë janë:

Niveli regional

- pranimi i kërkesave për pagesë viti 2016 (Sektor i vreshtave Masa 101, Masa ujitje e tokave Bujqësore dhe Masa 103) dhe vitit 2017 për të gjitha Masat si pasafateve kontratave
- kontrollimi i kërkesave për pagesë dhe dokumentacioni përcjellës
- kontrollimi i gjitha faturave dhe pagesave të bëra
- regjistrimi i kërkesës dhe faturave në sistem për menaxhimin e granteve

Niveli qendror

- kontrollimi, pranimi dhe regjistrimi i të gjitha kërkesave që vin nga zyret regjionale
- përgatitja e dosjeve dhe përgatitja e listave për kontroll të dytë,
- kalkulimi i faturave të dorzuara për investimet e kryera
- autorizimi i pagesës në bazë të raportit dhe faturave
- përgatitja e vendimeve për pagesë si dhe
- Përgatitja e listave të fermerve për pagesë

Pranimi i Kërkesave për Pagesë

Kërkesa për pagesë bëhet në zyret regjionale të Agjencionit për Zhvillimin e Bujqësisë (Prishtinë, Mitrovicë, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaji dhe Gjilani) dhe do të zgjas deri dy javë pas përfundimit të kontratave të miratuara për projekte të vitit 2016 tek Masa 103 (kësti i dytë), Masa Ujitje e Tokave Bujqësore (kësti i dytë), Masa 101- Sektor i



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

vreshtave, dhe Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale qasja LEADER (kësti i dytë). Poashtu do të bëhet pranimi i kërkesave për pagesë për të gjitha Masat e Programit për vitin 2017 të parapara sipas afateve të kontratave. Ky aktivitet fillon në shkurt dhe do të vazhdoj deri në fund të vitit për Programin e vitit 2016 dhe Programin e vitit 2017.

Gjatë procesit të pranimit të kërkesave për pagesë do të kontrollohet kompletimi i dokumentacionit në bazë të kriterëve të parapara si dhe pranimi i faturave për të gjitha investimet e kryera. Nëse kërkesa për pagesë dhe dokumentacioni përcjellës janë në rregull atëherë kërkesa për pagesë pranohet dhe regjistrohet në sistemin e menaxhimit të granteve ndërsa ato që nuk janë të kompletura i kthehen fermerit për përmisim. Kërkesat për pagesë të rregullta të pranuar në zyret regjionale grumbullohen dhe dorezohen në zyret qendrore të AZHB-së Divizioni i Autorizim të Pagesave të Projekteve të Zhvillimit Rural. Me këtë edhe perfundon procesi i kërkesës për pagesë.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti –Ky aktivitet do të filloj me pranimin e kërkesave të para për pagesë për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2016 dhe pritet të filloj në fundit të shkurt për projekte të vitit 2017 vazhdon deri në pranimin e kërkesës së fundit për pagesë me të gjitha Masat e vitit 2017.

Vlerësimi dhe regjistrimi i kërkesave në nivelin qendror - Të gjitha kërkesat e pranuar në zyret regjionale kontrollohen edhe njëherë nga zyrtarët për pranimin e kërkesave për pagesë në nivel qendror, riverifikohen dokumentet e kërkuara për plotësim të kriterëve të parapara për pagesë. Të gjitha kërkesat për pagesë të pranuar në pajtim me kushtet e përcaktuara në letërn e informimit dhe kontratën regjistrohen në librin e pranimit , ndërsa ato të pa kompletura kthehen në zyret regjionale për përmisim.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti –Ky aktivitet do të filloj me pranimin e kërkesave të para për pagesë për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2016 dhe 2017 dhe pritet të filloj në fillim të marsit , vazhdon deri në pranimin e kërkesës së fundit për pagesë.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Autorizimi për kontrollen në teren- Pasi të kryhet procedura e pranimit të kërkesave të gjitha kërkesat e pranuarë së bashku me dokumentacionin nga miratimi i projektit , komplotohet lënda dhe autorizohet lista për Divizionin e Kontrollit për kontrollën e dytë në teren. Qëllimi i kontrollës në teren është verifikimi i të gjitha investimeve të cilat janë paraqitur me fatura dhe pagesat që janë kryer në teren dhe a janë konform projektit, letrës së informimit dhe kontratës. Pas përfundimit të kontrollës së bashku me raport nga tereni kthehen përsëri në zyrën për autorizim të pagesës.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas pranimin e kërkesave të para në nivelin qendror për pagesë për PZHR 2016 dhe PZHR 2017, pritet të filloj në mars dhe vazhdon deri në pranimin e kërkesës së fundit për pagesë.

Kalkulimi i faturave – Pas përfundimit të kontrollës në teren të gjitha kërkesat për pagesë i nënshtrohen procedurave të kalkulimit të faturave të pranuarë për investimet e kryera. Në bazë të përshkrimit dhe fotografive të bëra nga inspektorët në teren, raporti nga tereni është një pasqyr që shihet se si fermeri ka kryer investimet, në këtë rastë faturat e dorëzuara do të krahasohen a janë konform investimeve të kryera në teren. Poashtu bëhet krahasimi i çmimeve të cilat janë paraqitur në fatura dhe a janë çmime të pranushme sipas çmimorës së AZHB-së, dhe në bazë të kësaj bëhet autorizimi i pagesës për secilin përfitues.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas kryerjes së kontrollës në teren dhe pritet të filloj në janar me PZHR 2016 me Masën 101- Sektori i vreshtave , Masa Ujitje e Tokave Bujqësore(kësti i dytë), Masën 103 (kësti i dytë) si dhe Rrjeti i Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale qasja LEADER (kësti i dytë) dhe vazhdon deri në fund të vitit, dy javë pas pranimit të kërkesës së fundit për pagesë me PZHR 2017.

Autorizimi i Pagesave dhe përgaditja e Vendimeve për Pagesë – Pas përfundimit të procesit të kalkulimit vazhdohet me autorizimit e pagesave për çdo fermerë. Vleratë cilën do ta përfiton fermeri varet nga raporti nga tereni, faturat dhe



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

pagesat e rregullta, planifikimet në projekt si dhe vlera në kontratë . Në momentin e përfundimit të autorizimit të vlerës për pagesë përgaditen vendimet për ekzekutim të pagesës. Për çdo pagesë përgatitet . Vendimi për Pagesë (një për AZHB dhe një për fermerin) nënshkruhen dhe vulosen.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas pranimin e kërkesave të para në nivelin qendror për pagesë për PZHR 2015 dhe pritet të filloj në janarit për Masën 101 dhe 302 (viti 2016) pastaj me Masa Ujitje e tokave Bujqësore (kësti i dytë) Masën 103 dhe Rrjetin e Zbatimi i Strategjive Zhvillimore Lokale qasja LEADER (viti 2016) dhe vazhdon dy javë pas pranimit të kërkesës së fundit për pagesë me PZHR 2017.

Përgatitja e Listave e fermerëve për Pagesë - Për të gjithë fermerët përfitues të projekteve të zhvillimit rural përgaditen listat për pages sipas masave dhe dërgohen në departamentin e financave në MBPZHR për ekzekutim të pagesës. Së bashku me listën për pagesë në zyrën e financave dërgohen komplet dokumentacioni i nevojshëm për ekzekutim të pagesave.

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me pas pranimin e kërkesave të para në nivelin qendror për pagesë për PZHR 2016 dhe pritet të filloj në fund të janarit dhe vazhdon tri javë pas pranimit të kërkesës së fundit për pagesë.

Raportimi për pagesa - Si detyrë e rregullt e vendit të punës është edhe përgatitja e raporteve të rregullta të punës. Për të gjitha aktivitetet e kryera nga ky divizion përgatiten raporte javore, mujore, tre mujore dhe vjetore. Përveq raportimit të rregullt përgatiten edhe raporte tjera varsisht prej nevojave . Në këto raporte zakonisht ofrohen të dhëna për fermerët dhe kompanitë e paguara te PZHR, ndarjen e përfituesve për masa, nënmasa dhe ndarja e raporteve në bazë të buxheteve nga i cili realizohet pagesa.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Periudha e kryerjes së këtij aktiviteti – Ky aktivitet do të filloj me e autorizimin e pagesave për projektet e vitit 2016 dhe vazhdon me pranimin dhe autorizimin e pagesave për PZHR 2017 gjatë tërë vitit.

Trajnimi i stafit të DAP

Duke pasë parasysh se çdo vit ndrojnë kriteret për masat e PZHR përsëri do të bëhet trajnimi i zyrtarëve regjional për procesin e kërkesës për pagesë për PZHR në mënyrë që zyrtarët të njoftohen me procesin e kërkesave për pagesë sidomos zyrtarëve të rinje të cilët do të inkorporohen në këtë aktivitet.

- Trajnimi i zyrtarëve të DAP (Zyret Regjionale të AZHB-së) mbi procedurat e kërkesave për pagesë per PZHR 2016.
- Trajnimi i zyrtarëve të DAP për përdorimin e sistemi i autorizimit të pagesave
- Vizitë studimore mbi procedurat e implementimit të Autorizimit të Pagesave sipas IPARD.
- Bashkëpunim të ngushtë me projektin “Përkrahje e mëtejme për MBPZHR” për forcimin e strukturave administrative për programimin, zbatimin dhe monitorimin, financuar nga BE.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

IV. DIVIZIONI I PAGESAVE DIREKTE

Divizioni i Pagesave Direkte është kompetent për implementimin e Programit për Pagesa Direkte si dhe zbatimin e procedurave sipas Udhezimit Administrativ 03/2017 për Pagesat Direkte në Bujqësi. Divizioni për Pagesa Direkte ka bërë planin operacional për implementimin e programit për Pagesa Direkte për vitin 2017. Planifikimi i implementimit të programit është bërë duke u bazuar në programin për pagesa direkte për vitin 2017.

Objektivat e divizionit të pagesave direkte per vitin 2017

- Organizimi i procesit për aplikim për Pagesa Direkte si dhe monitorimi i procesit të aplikimit
- Trajnimi me kohe i zyrtareve komunal dhe stafit të Divizionit të Pagesave Direkte
- Shqyrtimi administrativ i aplikacioneve për Pagesa Direkte brenda afateve optimale
- Kalkulimi i pagesave për të gjithë fermerët përfitues
- Përgatitja e vendimeve për miratim dhe refuzim brenda afateve kohore
- Përgatitja e raportit për implementim

Buxheti i planifikuar për Pagesa Direkte për vitin 2017 është gjithsej 25,000,000.00 € sipas tabelës në vijim:

Nr.	Sektorët që do të mbështeten përmes pagesave direkte	Buxheti (€)
1	Pagesa direkte për mbjelljen vjeshtore të grurit	6 750 000.00
2	Pagesa direkte për mbjelljen e farës së grurit	150 000.00
3	Pagesa direkte për mbjellje te elbit	50.000.00
4	Pagesa direkte për mbjellje te thekres	30.000.00



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

5	Pagesa direkte për mbjellje të misrit	2 700 000.00
6	Pagesa direkte për mbjelljen pranverore të lulediellit	20 000.00
7	Pagesa direkte për vreshta ekzistues	2 150 000.00
8	Pagesa Direkte per liter te prodhuar dhe deklaruar zyrtarisht	350 000.00
9	Pagesat direkte për pemishtet ekzistues	1 250 000.00
10	Pagesa direkte për prodhimtarinë e materialit fidanor të pemëve drufrutore dhe hardhisë së rrushit mbi nënshartesat vegetative	100 000.00
11	Pagesa direkte për perimet në fushë të hapur	1 700 000.00
12	Pagesa direkte për lopë dhe buallica qumështore	4 200 000.00
13	Pagesa direkte për delet	1 700 000.00
14	Pagesa direkte për dhitë	150 000.00
15	Pagesa direkte për bletari	2 000 000.00
16	Pagesa direkte për qumështin sipas kategorive të cilësisë	1 100 000.00
17	Pagesa direkte për pulat vojse	300 000.00
18	Pagesa direkte për dosa në riprodhim (Derrari)	25 000.00
19	Pagesat direkte për therjet e raportuara të gjedhit	75 000.00
20	Pagesat direkte për bujqesi organike	100 000.00
21	Pagesat direkte për thelleza	25 000.00
22	Pagesat direkte për akuakulture	75 000.00
Total buxheti për vitin 2017		25 000 000.00

Table 2. Buxheti për të gjitha Masat e PD - 2017



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

Programi për Pagesa Direkte është planifikuar të implementohet në afatet optimale duke rritur cilësinë gjatë implementimit. Numri i stafit që do të merret me implementim të Programit për PD këtë viti është 16 zyrtar. Si edhe viteve tjera, implementimi i Programit për Pagesa Direkte për vitin 2017 do të filloi me publikimin e thirrjes për aplikim ku të gjithë fermerët do të mund të aplikojnë me një aplikacion për të gjitha kulturat bujqësore. Thirrja për aplikim do të publikohet me date 16.02.2017 dhe do të zgjasë 45 dite kalendarike.

Pagesat direkte për sipërfaqe

Në kuader të Pagesave Direkte për sipërfaqe që do të subvencionohen këtë vitë përfshihen Pagesat Direkte për Grurë, farë gruri, theker, elb, miser, luledielli, vreshta, pemishte ekzistuese, bujqësi organike dhe perime në fushë të hapur. Numri i aplikacioneve për keto masa do të jetë rreth 17.000 aplikacione. Procesi i aplikimit është i organizuar në të gjitha komunat në nivel të Republikës së Kosovës. Është organizuar trajnim për të gjithë zyrtarët e Drejtorive komunale të bujqësisë lidhur me përdorimin e softuar-it si dhe janë njoftuar lidhur me programin për Pagesa Direkte për vitin 2017. Pas përfundimit të procesit të aplikimit do të filloi kontrolli administrativ i aplikacioneve. Kontrolli administrativ do të filloi në fund të muajit Prill dhe do të zgjasë rreth tre muaj.

Në kontrollin administrativ të aplikacioneve do të përfshihen aktivitetet si:

- Kontrolli i aplikacioneve lidhur me përshtatshmerine me kriteret e publikuara
- Kontrolli i aplikacioneve lidhur me përshtatshmerine me dokumentet e kërkuara
- Kontrolli i aplikacioneve lidhur me verifikimin e të dhënave personale

Vëmendje e veçantë do t'iu kushtohet kontratave të qiramarrjës si dhe fletave poseduese si dhe regjistrave të kafshëve.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Para fillimit të kontrollit administrativ të aplikacioneve do të mbahet trajnim për zyrtarët e Divizionit të Pagesave Direkte.

Paralelisht me kontrollin administrativ do të filloi edhe kontrolli në terren.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ për Pagesa Direkte në bujqësi për vitin 2017, kontrolli administrativ i aplikacioneve do të bëhet në masën 100 % për të gjitha aplikacionet, ndersa kontrollet në terren sa i perket pagesave direkte për sipërfaqe do të bëhen sipas përqindjës së mëposhtme:

Pagesa Direkte-Grurë, do të kontrollohen në terren së paku 40% e aplikacioneve

Pagesa Direkte-Fare gruri, do të kontrollohen në terren 100 % e aplikacioneve

Pagesa Direkte-Miser, do të kontrollohen në terren se paku 40 % e aplikacioneve

Pagesa Direkt-Elb dhe theker, do të kontrollohen në terren se paku 40 % e aplikacioneve

Pagesa Direkte-Luledielli, do të kontrollohen në terren se paku 40 % e aplikacioneve

Pagesa Direkte-Perime në fushe të hapur, do të kontrollohen në terren se paku 40 % e aplikacioneve

Pagesa Direkte-Pemishte ekzistuese, do të kontrollohen në terren 40 % e aplikacioneve

Pagesa Direkte-Vreshta, do të kontrollohen në terren se paku 30 % e aplikacioneve

Planifikohet që kontrolli në terren të mund të fillojë nga data 01.05.2017. Ekipet e kontrollit në terren në vazhdimësi do të furnizohen me aplikacione për kontroll në terren.

Përzgjedhja për kontrollë në terren do të bazohet në mostren e cila do të përgatitet pas përfundimit të procesit të aplikimit varesisht prej vleresimit të rrezikut.

Pas përfundimit të kontrollit administrativ dhe kontrollit në terren do të fillojë kalkulimi i pagesave për fermerët përfitues.

Te gjithë fermerëve do t'u përgatitet vendimi për pagese ose refuzim varesisht prej rezultateve të kontrollit në terren.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Sa i perket planifikimit të pagesave, ato do të fillojnë kah mesi i muajit Korrik dhe në vazhdimësi do të bëhen pagesa varesisht prej kontrolleve në terren. Planifikohet që deri në fund të vitit të kemi disa lista të pagesave.

Pagesat direkte ne blegtori

Në kuader të programit për Pagesa Direkte për vitin 2017 do të subvencionohen fermerët që mbareshtojne lope qumështore, buallica qumështore, dele dhe dhi qumështore, dosa, bletë, pula vojse, qumësht sipas cilesisë dhe therrjet e kafsheve, thëllezat.

Në kuader të Pagesave Direkte ne blegtori presim që të kemi rreth 10.000 aplikacione. Kontrolli administrativ i aplikacioneve do të bëhet në masën 100 %.

Kontrolli në terren do të bëhet si në vijim:

Pagesat Direkte-Lope qumështore dhe buallica, do të kontrollohen në terren se paku 60 % e aplikacioneve

Pagesat Direkte-Dele dhe dhi, do të kontrollohen në terren se paku 60 % e aplikacioneve

Pagesat Direkte-Blete, do të kontrollohen në terren 80 % e aplikacioneve

Pagesat Direkte-Dosa, do të kontrollohen në terren 100 % e aplikacioneve

Pagesat Direkte-Pula vojse dhe thëllezat, do të kontrollohen në terren 100 % e aplikacioneve

Kontrolli administrativ i aplikacioneve për Pagesa Direkte në blegtori do të bëhet paralelisht me ato të Pagesave Direkte për sipërfaqe.

Aplikacionet do të jenë të gatshme për kontroll në terren nga data 01.05.2017.

Kalkulimi i pagesave, përgatitja e vendimeve për miratim dhe refuzim do të filloi gjatë muajit Korrik.

Sa i perket Pagesave Direkte për qumësht sipas cilesisë dhe therrjeve të kafsheve, thirrjet për aplikim do të bëhen sipas tremujoreve kalendarik të vitit. Gjithashtu edhe kontrolli administrativ dhe pagesat do të bëhen çdo tre muaj.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Pagesat direkte - Material fidanor dhe Akuakulture

Pagesat Direkte për material fidanor do të vazhdojnë edhe në vitin 2017. Në kuader të kësaj mase kemi një numër të vogël të aplikuesve që sillet rreth 20 fermer aplikues.

Do të kontrollohen të gjithë fermerët në terren në masën 100 %. Kontrolli në terren planifikohet të bëhet në fund të muajit Tetor ose në fillim të muajit Nentor 2017.

Pagesat Direkte për akuakulture do të vazhdojnë edhe në vitin 2017, me një numër simbolik të aplikuesve rreth 10 fermer.

Thirrja për aplikim do të jete çdo gjashtë muaj. Do të subvencionohen fermerët që kanë hurdha të peshqeve dhe që prodhojnë se paku 2500 kg peshk të fresket çdo gjashtë muaj.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

V. DIVIZIONI I KONTROLLIT NË TEREN

Në këtë plan do të prezantohet aktivitetet e parapara që do të zhvillohen nga Divizioni i Kontrollit në teren gjat vitit 2017 .Ky Plan Pune ka për qëllim të parashikojë ,të orientojë dhe të realizoj aktivitetet që do të kryhen gjat vitit për realizimin e kontrollit në teren për Programit Mbështetës për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të hartuar nga Autoriteti Menaxhues i MBPZHR ,duke u bazuar në kriteret dhe kushtet e dizajnuara nga ky Insitucion.Në rrjedhë e sipër ky Plan do të zbatohet me konstatimin e të gjeturave bazuar poashtu edhe në Udhëzimet Administrative të Parapara për këto fusha kontrolli ,Udhëzuesit e brendshëm që hartohen për të detajizuar aspekte të ndryshme të kriterëve dhe Rregulloret e Kontrollit në teren.

Resurset në dispozicion të Divizionit të Kontrollit

Aktualisht (gjat vitit 2017,një pjesë e stafit deri në qershor/12Divizioni i Kontrollit operon me një staf prej :

- Menaxher në Qendër - 3 (Shefi i Divizionit dhe Dy Përgjegjës për Sektorët Përkatës të Kontrollit)
- Inspektorë Tereni - 45 , në 7- Zyrat Regjionale
- Automjete - 21
- Lap/Top,GPS, - 42
- Odometra (Shiritmatës) - 20

Poashtu ky Plan i Punës së Divizionit të Kontrollit të AZHB ,bazohet edhe në aktivitetet e Divizioneve tjera të AZHB ,si Divizioni i Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural ,Divizioni i Pagesave Direkte,Divizioni i Autorizimit të Pagesave, Administratës dhe Teknologjisë Informative duke harmonizuar aktivitetet në përgjithësi me qëllim koordinimin e duhur të punëve dhe qëllimin final Realizimin e Programit të paraparë. Punët për zbatimin e kontrollit në teren ngërthejnë në vete shumë aktivitete që ndërliken



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

edhe me Sektorët e lartëcekur dhe duke u bazuar në resurset në dispozicion hartohen edhe parametrat dhe normat e kontrollit në teren për arritjen e objektivave të parashtruar.

Objektivat e Divizionit të Kontrollit në Teren për vitin në vijim do të jenë:

1. Plotësimi i majngësive Tekniko profesionale me personel ,mjete teknike të kontrollit dhe logjistikë
2. Plotësimi dhe rifreskimi i të dhënave në Dokumentet Administrative të Divizionit të Kontrollit në teren
3. Realizimi i Kontrollit në teren për Pagesa Direkte sipas dinamikës së paraparë
4. Realizimi i Kontrollit në teren për Projektet e Zhvillimit Rural sipas dinamikës së paraparë për përmbylljen e Programit 2017
5. Rritja e cilësisë së kontrollit në të gjitha masat e parapara për kontrollë si tek Pagesat Direkte dhe Projektet e Zhvillimit Rural
6. Rritja e performanceës së ekipeve në sasi dhe cilësinë e kontrollit

Do të fillohet me procedurat e zakonshme Administrative siq janë:

- ✓ Finalizimi i Raportit Vjetor të Punës
- ✓ Vlerësimi i të punësuarve për vitin paraprak
- ✓ Planet Individuale Vjetore të Punës
- ✓ Plani i Punës për Divizionin e Kontrollit në teren
- ✓ Menaxhimi i Pushimeve dhe Orëve shtesë të Inspektoratit

Këto aktivitete kryhen zakonisht në muajin e parë dhe të dytë të vitit .

Duke pasur parasysh se ka projekte të miratuara më vonë ,do të vazhdohet me kontrollet e dyta për këto projekte, (Ankesa,Rikontrolle etj),kërkesa për kontrollë në teren nga Divizioni i Autorizimit të Pagesave, ku do të menaxhohet përfundimi i kontrollit për



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Projektet e mbetura të vitit paraprak dhe eventualisht kërkesat për rikontrollë të projekteve të parealizuara tërësisht.

Poashtu sipas Normave Ligjore do të vazhdohet me **Ex-Post kontrollin dhe Superkontrollin** për përfituesit e vitit 2014 me ç'rast do të kryhet evidentimi dhe të gjeturat për këta përfitues për : Vazhdimësinë e Aktivitetit, Gjendjen e paisjeve dhe projekteve të përfituara. Ky aktivitet do të përfshij tre muajt e parë të vitit në vijim.

- ✓ Vazhdimi i Kontrolleve me Kërkesa të Sektorit të Autorizimit
- ✓ Kontrollat me Kërkesa të **Komisioneve të Ankesave** për Pagesa Direkte dhe Projektet e Zhvillimit Rural
- ✓ Fillimi i Ex - Post Kontrollit për Përfituesit e vitit 2014

Aktivitete kontrolli në teren - për Kontrollin e dytë të Projekteve të Zhvillimit Rural do të zhvillohen deri në Qershor të këtij viti ku do të realizohet kontrolli i dytë për Masën 103 - Përpunimi. Gjat muajit prill do të puna dhe aktivitetet do të fokusohen në:

- ✓ Trajnimin e stafit ,
- ✓ Përpilimin dhe hartimin e udhëzuesve për inspektor ,
- ✓ Verifikimin e gjendjes së dhe paisjes së inspektoratit me mjete teknike të kontrolli dhe logjistikë
- ✓ Përgatitjen dhe përshtatjen e Proçesverbleve dhe Raporteve të Kontrollit në teren sipas Masave dhe ndryshimeve që mundë të jenë në Program
- ✓ Vazhdimi i kontrolleve me kërkesa të Sektorit të Autorizimit të Pagesave
- ✓ Përgatitjet Teorike për Kontrollë të Programit 2017- Analiza dhe studimi i Kritereve, Udhëzuesve dhe Udhëzimeve Administrative për Pagesat Direkte dhe Projektet e Zhvillimit Rural
- ✓ ,Dokumentacioni dhe Përshtatja e Raporteve dhe Aspekteve tjera sipas Masave- PD dhe PZHR -Zyra Qendrore e Inspektoratit



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

- ✓ Fillimi dhe zbatimi i Trajnimeve për Inspektoratin në teren – Parapërgatitje për Kontrollin e Programit të Ri-2017
- ✓ Përcaktimi i Ekipeve të Kontrollit, Paisja me Automjete dhe Paisje teknike të Kontrollit
- ✓ Finalizimi i Raportit të Ex-Post Kontrollit për Përfituesit e vitit-2014

Sipas Planit të paraparë dhe harmonizuar me Divizionin e Pagesave Direkte kontrolli për Pagesa Direkte pritet të filloj nga fillimi i Majit, me ç'rast sipas programit pritet të ngarkohen me kontrollë stafi për menaxhimin e kontrollit në teren sipas Programit dhe ky aktivitet siq dihet vazhdon pothuajse gjat tërë vitit meqë kërkesa për kontrollë për Pagesa Direkte dhe Normat e kontrollit janë shumë të larta si dhe fillimi i kontrollit është shumë i vonshëm, do të jet një aktivitetet shumë I ngjeshur kontrolli meqë në këtë periudhë vijnë pothuajse të gjitha kërkesat për kontrollë : Pagesa Direkte, Kontrolli I Parë nga Divizioni i Miratimit, Kërkesa për kontrollë të dytë nfga Divizioni I Autorizimit. Aktivitetet e mëposhtme specifikojnë dhe ilustrjnë këto rrjedha pune. Poashtu në këtë periudhë do të zhvillohen aktivitete me Divizionin e Teknologjisë Informative dhe Regjistrave me qëllim Rifreskimin e Programit të sLPIS në kompjuterët Portativ të Inspektoratit ,paisjen me kompjuterë të ri në rastet e mungesave dhe GPS, rishikimi I menaxhimit të të dhënave për Modulin e Kontrollit për Projektet e Zhvillimit Rural.

- ✓ Filimi i Kontrollit për Programin -2017 ,për Pagesa Direkte
- ✓ Zbatimi i Kontrollit në Teren për Pagesa Direkte : Grurë ,Elb,Thekër,Perime në fushë të hapur,
- ✓ Kontrolli i Dytë për Masën 103 – Autorizimi i Pagesave
- ✓ Fillimi i Kërkesave për Kontrollë nga Divizioni i Miratimit të Projekteve- Projektet e Zhvillimit Rural-Kontrolli i Parë-Para Miratimit



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

- ✓ Vazhdimi i Kontrollit për Pagesa Direkte dhe Pojektet e Zhvillimit Rural - Kontrolli i Parë
- ✓ Menaxhimi i kontrollit,risistemimi i Ekipeve të Kontrollit dhe Logjistikës
- ✓ Vlerësimi i Gjashtëmujorit të Punës
- ✓ Fundi i Qershorit-Përfundimi i Kontrollit të Parë-Para Miratimit për PZHR

Llogaritet që fundi I qershorit të përfundoj kontrolli për : Disa nga Masat e Pagesave Direkte,Kontrolli I Dytë për Masën 103/2016 nga Sektori I Autorizimit të Pagesave dhe Kontrolli I Parë nga Sektori I Miratimit të Projekteve të Zhvillimit Rural.

Në këtë periudhë ,nga fillimi I muajit korrik do të përveç organizimit dhe menaxhimit të kontrollit në teren ,parashihet të zhvillohen aktivitete si :

- ✓ Analiza e kontrollit rrjedha e tij në sasi dhe cilësi
- ✓ Rishikimi i Ekipeve dhe Logjistikës
- ✓ Menaxhimi i Kontrollit në teren dhe Pushimeve të Inspektoratit
- ✓ Vazhdimi i Kontrollit për Pagesa Direkte
- ✓ Vazhdimi i Kontrollit për Pagesa Direkte - Masat në vijim
- ✓ Vlerësimi I punës së inspektoratit për punët dhe aktivitetet e gjashtëmujorit

Në këtë periudhë zakonisht evdenohen të metat,mungesat dhe rishikohen zonat e prapambetura në kontrollë,arsyet e ngecjeve dhe rifreskohen ekipet dhe logjistika duke u risistemuar dhe plotësuar me personel,logjistikë dhe mjete teknike të kontrollit.

Në tremujorin gusht shtator, dhe tetor parashihet përfundimi I programit të të kontrollit për Pagesat Direkte, hartimi I raporteve përfundimtare të kontrollit,korrigjimi I gabimeve të mundshme,shqyrtimi I Ankesave ndaj kontrollit dhe rishikimi I tyre në teren



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

rikontrolli për verifikimin dhe evidentimin e sakt të të gjeturave duke mundësuar finalizimin e pagesave për këtë kategori të aplikantëve.

Poashtu do të fillojnë përgatitjet për fillimin dhe zbatimin e kërkesave për kontrollë të dytë të Projekteve të Zhvillimit Rural.

Aktivitetet në vijim pasqyrojnë periudhën e përshkruar:

- ✓ Vazhdimi i kontrollit për Pagesa Direkte
- ✓ Shqyrtimi I Ankesave dhe gabimeve gjat kontrollit në teren
- ✓ Rikontrolli eventual
- ✓ Fillimi I kontrollit të Dytë për Masat e Zhvillimit Rural Pas Miratimit dhe Para Pagesës
- ✓ Përfundimi i Kontrollit për Pagesa Direkte

Tremujorin e fundit Tetor Nëntor dhe gjysma e pare e Dhjetorit do të zhvillohen kryesisht aktivitete kontrolli në teren, për verifikimi dhe konstatimin e të gjeturave për Projektet e Zhvillimit Rural të Masave dhe Nënmasave të ndryshme të parapara në Program ku kooperimi dhe bashkërendimi i punëve do të orientohet me Divizionin e Autorizimit të Pagesave . Kërkesat për Pagesë dhe Verifikimi në teren për konstatimin e gjendjes së realizimit të Projekteve të Zhvillimit Rural.Poashtu gjat kësaj periudhe Divizioni i Kontrollit në Teren zakonisht i parashtrohen edhe kërkesa për kontrollë nga ana e Komisioneve Qendrore të Ankesave me ç'rast do të bëhet Rikontrollet dhe rivlerësimet në teren të gabimeve të mundshme (nga ana e AZHB ose Aplikantëve), kjo periudhë përkon me këto aktivitete:

- ✓ Kontrollin përfundimtar në teren për përmbylljen e ekzekutimit të pagesave për Projektete e Zhvillimit Rural ku Divizioni i Kontrollit angazhohet në përmbylljen e Raporteve me të gjeturat e aplkantëve
- ✓ Rivlerësimin e aktiviteteve dhe punës vjetore të personelit



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

- ✓ Rivlerëmin e mjeteve teknike dhe logjistike gjendjes së tyre
- ✓ Nxjerrjen e konkluzioneve për normën e realizimit të detyrave të parashtruara
- ✓ Nxjerrjen e konkluzioneve për vështirësitë e paparashikuara me program dhe vërejtjet ndaj tij
- ✓ Vlerësimin real të normave të kontrollit në teren dhe problemet e hasura
- ✓ Vlerësimin e performanceës në sasi dhe cilësi të kontrollit sipas Ekipeve të Inspektorëve dhe Divizionit në tërësi.

Aktivitetet	Vlerësimi, Raporti Final Planet Individuale Vazhdimi I Kontrollit-PZHR-2016	Monitorimi I Zyrove, Logjistikës dhe Paisjeve të kontrollit- Servisimet -Rekomandimet e Komisioneve/PD,PZHR	Ex-Post Kontrolli	Parapërgatitja për fillimin e kontrollit- Trajnimi I Stafit për kontrollë në teren	Kontrolli I Pagesave Direkte	Masat Tjera-PD	Kontrolli I Parë I PZHR	Kontrolli I Dytë PZHR	Palët e involvuara
Janar									DAP/ D.Autorizimi
Shkurt									DAP/ D.Autorizimi
Mars									DAP/ D.Autorizimi
PRILL									DAP/ D.Autorizimi
Maj					Gruri, Elbi	Masat Tjera të			DAP/ D.Autorizimi PD , DMVP
Qershor					Thekra, Perimet në Fushë të Hapur	Pagesave Direkte			DAP/ D.Autorizimi PD , DMVP
Korrik					Gjysma e Korrikut				PD
Gusht									PD
Shtator									PD D.Autorizimi
Tetor									DAP/ D.Autorizimi PD , DMVP
Nëntor									PD D.Autorizimi
Dhjetor									PD D.Autorizimi

Table 3. . Plani i implementimit i kontrollit



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

VI. DIVIZIONI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE REGJISTRAVE

Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave gjatë vitit 2017 ka planifikuar administrimin e të gjithë regjistrave që gjenden në Agjencin për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) si:

- **Regjistri Elektronik i Fermëve (eFR)**
- **Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS)**
- **sLPIS-Mobile i cili përdoret për kontrollë në teren për sipërfaqe**
- **Softueri për Menaxhimin e Pagesave Direkte i cili përfshin:**
 - ✓ Moduli i aplikimit në zyret komunale
 - ✓ Moduli për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB
- **Softueri për Menaxhimin e Granteve i cili përfshin:**
 - ✓ Modulin për zyrën regjionale (regjistrimin e aplikacioneve dhe kërkesën për pagesë)
 - ✓ Menaxhimin e granteve
 - ✓ Autorizimin e pagesave të granteve
 - ✓ Moduli i menaxhimit të kontrollit në teren
- **Softueri për Indikator si dhe**
- **Ueb faqja e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.**

Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave gjatë vitit 2017 ka planifikuar të bëjë mirëmbajtjen e të gjithë kompjuterëve dhe rrjetit të internetit të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë duke përfshirë edhe Zyrët Regjionale. Gjatë vitit 2017 Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave do të bëjë monitorimin e Blade enclosure, blade server, MSA



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

storage dhe ultrium tape drive gjithashtu edhe krijimin e virtual servereve për instalimin e softuereve të rinjë që zhvillohen për AZHB-në.

Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave gjatë vitit 2017 do të bëjë menaxhimin e llogarive zyrtare (emaili zyrtar) resetimin e fjalëkalimit, vazhdimin e afatit, krijimin e shfrytëzuesëve të rinjë për qasjen në domenin shtetror. Të gjithë zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë gjatë vitit 2017 do të jenë të qasur në server (share folder) për ruajtjen direkte të të dhënave në server. Nga Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave do të bëhet ruajtja (backup) i të gjitha të dhënave që janë të ruajtura në server (share folder), ruajtja (backup) e të dhënave për Softuerin për Menaxhimin e Granteve (në këtë softuer përfshihet ueb modulini për aplikim për Grante, moduli i aplikimit për grante dhe plotësimi i kërkesës për pagesë në Zyrët Regjionale të AZHB-së, menaxhimi i granteve, autorizimi i pagesave të granteve si dhe moduli i kontrollit në teren), ruajtja (backup) i ueb aplikacionit të Pagesave Direkte (në këtë softuer përfshihet moduli për aplikimit në zyret komunale si dhe modulini për menaxhimin e Pagesave Direkte), gjithashtu edhe ruajtja (backup) i të dhënave të serverit ku është instaluar Regjistri Elektronik i Fermëve (eFR) dhe Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS), softueri i Indikatoreve dhe uebfaqja e AZHB-së.



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development

Në këtë skemë mund të shihet lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) që do të funksionojë gjatë vitit 2017




Figura 3. Lidhja e regjistrave të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) që do të funksionojë gjatë vitit 2017



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR)

Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR) do të thotë listë e kompjuterizuar e të dhënave të hartuara nga ana e institucionit përkatës brenda Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (MBPZHR-AZHB) me qëllim të identifikimit të fermerëve që mund të përfitojnë nga mbështetja financiare nga autoritetet kombëtare dhe/ose burime të tjera, si dhe fermerët të cilët dëshirojnë të regjistrohen në bazë vullnetare.

Regjistri elektronik i fermerëve (eFR), databaza e eFR-së është e instaluar në server të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) ku serveri është i hostuar në dhomën e servereve të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike ku gjatë gjithë kohës është funksional. Regjistrimi i fermerve gjatë vitit 2017 është paraparë të bëhet në zyrët komunale në Drejtoratet e Bujqësisë dhe në Zyrët Regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Në vitin 2017 do të bëhet krijimi i përdoruesve sipas kërkesave që do të bëhen nga Drejtoratet e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) dhe nga zyrtaret komunal varësisht sipas pozitës së zyrtarit do të ju krijohen përdoruesit. Administrimi i këtij regjistri bëhet nga Drejtorati i Regjistrave

Regjistrimi i fermerve është i rregulluar me "Udhëzim Administrativ nr.012/2016 për regjistrin e fermerve", gjatë vitit 2016 është bërë plotësim ndryshimi i Udhëzim Administrativ nr.07/2011 për regjistrin e fermerve. Regjistrimi në regjistrin e fermerve është vullnetar nuk është obligativ, obligativ është vetëm për fermerët që aplikojnë për grante dhe subvencione. Regjistri Elektronik i Fermerve (eFR) ka filluar të funksionoi në vitin 2012 dhe gjatë këtij viti janë regjistruar 16,608 fermer, në vitin 2013 kanë qenë të regjistruar 26,603 fermer, në vitin 2014 kanë qenë të regjistruar 34,775, në vitin 2015 kanë qenë të regjistruar 43166 fermer kurse në fund të vitit 2016 përkatësisht me 31.12.2016 numri i fermerve të regjistruar ka arritur në 50164 fermer në 37 komuna të Kosovës. Gjatë



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

vitit 2017 presum rritje të numrit të fermerëve të regjistruar në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR) prej 6000 deri në 8000 fermer pasi që është rritur numri i Masave dhe Nenmasave si të Pagesave Direkte ashtu edhe të Projekteve të Zhvillimit Rural.

Gjatë gjithë vitit 2017 është paraparë mbështetje direkte e zyrtarve komunal dhe zyrtarve regional të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) për regjistrimin e fermerëve në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR).

Në Regjistrin Elektronik të Fermerëve (eFR) gjatë vitit 2017 do të përfshihen të dhënat për fermerin, tokën në shfrytëzim, të dhënat për kafshë, mekanizmi bujqësor si dhe nënshkrimi i fermerit.

Për fermerin gjatë vitit 2017 do të përfshihen të dhënat për emrin, mbiemrin, emrin e babës, datëlindjen, numrin personal, gjuhën e fermerit, komunën, vëndbanimin, telefonin, e-mailin, koordinatat e fermës që do të mirren nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) emri i bankës dhe numri i xhirollogarisë, etj.

Për tokën në shfrytëzim gjatë vitit 2017 do të përfshihen të dhënat për tokën e punueshme si: ara, kopshte, lëndinë e përhershme, pemishte, vreshta, pyje, të dhënat plotësohen për sipërfaqën e tokës në pronë në hektar dhe sipërfaqën e tokës në huazim me qëra, patate mbi 10 (dhjetë) hektar, drithëra mbi 50 (pesëdhjetë) hektar, bimë industriale, hortikulturë e hapur mbi 3 (tre) hektar, hortikulturë e mbuluar mbi 0.30 (zero pikë tridhjetë) hektar.

Për kafshë gjatë vitit 2017 do të përfshihen të dhënat për lopë qumështore, mëshqerra (mbi dy vite), dema (mbi dy vite), një deri në dy vite meshkuj, një deri në dy vite femra, dele për mbarështim, dele (desh, qingja, rrunza), dhi për mbarështim, dhi (cjep, keca, ftuja), derra nën 20 (njëzet) kg, dosat për mbarështim mbi 50 (pesëdhjetë) kg, derra tjerë, kuaj, gomarë, pula, zogj, bletë etj.

Për mekanizëm gjatë vitit 2017 do të përfshihen të dhënat për traktorë, motokultivatorë dhe autokombanja dhe është pjesa e nënshkrimit ku në këtë pjesë do të përfshihen të dhënat për datën e regjistrimit dhe vendin e regjistrimit.



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

Pas regjistrimit të fermerit gjenerohet NIF, "NIF" do të thotë Numri Identifikues i Fermës. Pasi të bëhet gjenerimi i NIF-it është e mundur shtypja e çertifikatës së fermerit dhe aneksit me të dhënat e fermerit ku në aneksin e eFR-së nënshkruhet zyrtari përgjegjës gjatë regjistrimit dhe fermeri.

Në skemën e mëposhtme mund të shihet procesin e regjistrimit të fermerit ne eFR gjatë vitit 2017




Figura 5. Procesi i regjistrimit të fermerit në eFR gjatë vitit 2017



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

Gjatë vitit 2017 për aplikim per Pagesa Direkte do të hapet kampanja për aplikim për krerë në softverin për menaxhimin e pagesave direkte ku ky softver është lidhur me sLPIS (Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) dhe me eFR (Regjistri Elektronik i Fermerve) Përmes këtij sistemi aplikohet për te gjitha subencionet e Pagesve Direkte. Për sipërfaqe se pari bëhet digjitalizimi i parcelave në sLPIS (Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës) pastaj kalohet direkt ne softverin e Pagesave Direkte për aplikim per sipërfaqe aplikimi bëhet për 48 kultura bujqësore e ato janë: grurë, farë gruri, elbit, thekrës, misër, luledielli, lakër, lulëlakër, spinaq, presh, qepë, hudhër, panxhar, karrota, domate, patëllxhan, tranguj, patate, shalqinjë, pjepër, kungull gjelle i gjelbër (kungulleshë), kunguj misri, fasule monokulturë, bizele, kunguj, speci, marulla, magdanoz, rrepka, asparagu dhe brokoli. Për sa i përket aplikimit për subvencione për kafshë, material fidanor bëhet aplikimi përmes këtij sistemi për: lopë qumështore, buallica, bletë, dele, dhi, pula, dosa, qumështë për liter, kafsheve të therrura, numri i fidaneve si dhe akuakultur.

Softueri për Menaxhimin e Pagesave Direkte

Softueri për Menaxhimin e Pagesave Direkte: Ky ueb aplikacion do të përfshin dy module: moduli për aplikimit në zyret komunale dhe modulin për menaxhimin e Pagesave Direkte në AZHB. Përmes këtij ueb aplikacioni do të bëhet aplikimi për te gjitha pagesat direkte per sipërfaqe (grur, miser etj, kultura permtare permanente) si dhe te gjitha aplikimet per krerë (lopë qumështore, dele, dhi, bletë etj.). Ky aplikacion është i nderlidhur edhe me sLPIS (Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës) ku pas digjitalizimit te parcelave behet aplikimi permes keti ueb aplikacioni. Më ueb aplikacionin e pagesave direkte bëhet kontrolli administrativ i aplikacioneve, procedimi i lëndëve për kontroll në teren, kalkulimi i pagesave, përpilimi i listave për pagese si dhe



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

dergimi i sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për t'u njoftuar lidhur më vendimin e marr për aplikacionin e tij, përmes këtij ueb aplikacioni bëhet komplet menaxhimi i pagesave direkte. Gjatë vitit 2017 Divizioni i IT dhe Regjistrave në këtë ueb aplikacion do të bejë krijimin e shfrytëzuesëve (usereve), rikthimin në aplikim të aplikacioneve që kanë bërë gabime zyrtaret komunal gjatë aplikimit si dhe mirëmbajtjen e të dhenave.

Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS)

Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) përmes këtij sistemi është paraparë të bëhet digjitalizimi i 48 kulturave bujqësore në vitin 2017, pas nënshkrimit të Programit për Pagesa Diekte 2017 Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) do të përgaditet për aplikim për sipërfaqe për 48 kultura bujqësore e ato janë: grurë, farë gruri, elbit, thekrës, misër, luledielli, lakër, lulëlakër, spinaq, presh, qepë, hudhër, panxhar, karrota, domate, patëllxhan, tranguj, patate, shalqinjë, pjepër, kungull gjelle i gjelbër (kungulleshë), kunguj misri, fasule monokulturë, bizele, kunguj, speci, marulla, magdanoz, rrepka, asparagu dhe brokoli . Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) do të përgaditet edhe për aplikim për sipërfaqe për kultura pemtare permanente e ato janë: molla, dardha, ftua, mushmolla, kumbulla, kajsia, pjeshka, qershija, vishnje, dredhëza, manaferra, mjedra, boronica, vreshta, arra, lajthia, dhe aronia. Pas përgaditjes së Sistemit të Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) do të bëhet hapja e kampanjes ku pas hapjes së kampanjës është planifikuar trajnimi i zyrtarëve komunal për digjitalizimin e parcelave dhe është planifikuar të ju ipet mbështetje direkte gjatë digjitalizimit të parcelave gjatë kohës së aplikimit të fermerëve për mbështetje direkte për sipërfaqe. Gjatë vitit 2017 do të bëhet krahasimi i ortofotove të vitit 2009 dhe 2012 ku mund të shfaqen



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

ortofotot dhe mund të bëhen krahasime ne mes tyre, gjithashtu mund të bëhet edhe krahasimi i parcelave të digjitalizuara me heret gjatë aplikimit nepër vite. Gjatë vitit 2017 do të bëhet edhe shiqimi i parcelave ne Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) permes Agjencis Kadastrale të Kosovës ku është bërë lidhja permes Geoportalit dhe mund të shihen parcelat si janë të regjistruara ne Agjencionin Kadastrale të Kosovës.

Me poshtë mund të shihni se si duket lidhja e sLPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit




Figura 6. Lidhja e LPIS-it me Agjencinë Kadastrale të Kosovës përmes Geoportalit



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development

Më poshtë mund të shihni Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS):




Figura 7. Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës (LPIS)



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development

Në këtë skemë mund të shihet funksionimi i sLPIS-it dhe sLPIS-MOBILE




Figura 8. Skemë si funksion LPIS-it dhe LPIS-MOBILE

sLPIS-Mobile

sLPIS-Mobile Për kontrollë në teren sipërfaqet që kanë aplikuar fermeret pë mbeshtetje direkte, inspektorët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë përdorin sLPIS-Mobile i cili funksionon pa qasje në rrjet të internetit (offline) ku gjatë vitit 2017 do të ngarkohen të dhënat nga Sistemi i Thjeshtësuar i Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS) në sLPIS-



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/ Agency for Agricultural Development

Mobile, vetem me qasje të llaptopit në rrjet qeveritar bëhet bartja e të dhënave nga LPIS-Mobile në Sistemin e Thjeshtësuar të Identifikimit të Parcelave të Tokës (sLPIS), ngarkimi i të dhënave bëhet shumë shpejt me një komandë e cila bën transferimin e të dhënave. Konfigurimi i sLPIS-Mobile në llaptop gjatë vitit 2017 do të bëhet nga Divizioni i Teknologjisë Informative dhe Regjistrave po ashtu edhe konfigurimi i GPS-ve që përdorin inspektorët në teren.

Softueri Grant Menaxhment

Softueri Grant Menaxhmenti: Ky softuer përmban modulën:

- Modulën për zyrën regjionale (regjistrimin e aplikacioneve dhe kërkesën për pagesë)
- Menaxhimin e granteve
- Autorizimin e pagesave të granteve
- Moduli i menaxhimit të kontrollit në teren

Softueri për aplikim për grante dhe kërkesën për pagesë: Ky modul është instaluar në zyrën regjionale të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB ku gjatë vitit 2017 ky softuer është paraparë të përgaditet për aplikim sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2017. Ruajtja e të dhënave gjatë aplikimit do të bëhet në server të AZHB-së dhe gjatë gjithë kohës zyrtarët përgjegjës të menaxhimit të granteve mund të shohin të dhënat e fermerve që kanë aplikuar. Ky softuer mundeson edhe plotësimin e kërkesës për pagesë ku regjistrohen të gjitha fakturat që sillen nga fermeri që ka bërë kërkesë për pagesë.

Menaxhimi i granteve: Gjatë vitit 2017 Softueri për Menaxhimin e Granteve do të përgaditet sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2017 për menaxhimin e granteve të vitit 2017 dhe nga ky softuer po ashtu do të bëhet edhe përpilimi i kontratave që do të nënshkruj Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB me fermer si dhe dërgimin



**Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development**

e sms-it në telefon mobil tek fermerët dhe dërgimi i vendimit në emalin e fermerit për t'u njoftuar lidhur më vendimin e marr për aplikacionin e tij. Pas aplikimit në softuerin për aplikim për grante, zyrtarët e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë - AZHB fillojnë me poentimin e tyre sipas kriterëve që janë të rregulluara me Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2017.

Autorizimi i Pagesave: Gjatë vitit 2017 është planifikuar plotësimi i modulit të Autorizimit të Pagesave sipas Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2017 ku kërkesat për pagesë do të plotësohet në zyret regjionale të AZHB-së, kalkulimi dhe autorizimi i pagesave do të bëhet nga zyrtarët e Autorizimit të Pagesave ku bëhet kalkulimi i fakturave dhe përpilimi i listave për kontrollë në teren dhe përgaditja e listës për pagesë.

Softueri për Indikator: Gjatë vitit 2017 plotësimi i Indikatoreve do të bëhet automatik pasi që Softueri për Indikator dhe Grant Menaxhmenti janë të ndërlidhur në mes veti dhe është bërë harmonizimi i të gjitha tabelave ku bëhet shkembimi automatik i të dhënave.

Ueb faqja: Mirëmbajtja e ueb faqës së Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB) edhe gjatë vitit 2017 do të bëhet nga Divizioni i IT dhe Regjistrave. Gjatë vitit 2017 do të publikohen të gjitha thirrjet për aplikim për Grante dhe Subvencione, formularët për aplikim, listat e përfituesve të granteve dhe subvencioneve, udhëzuesit për aplikant, udhëzimet administrative si dhe materiale të ndryshme informuese të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB).



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agjencia za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development

		Plani i punës 2017																																															
		JANAR-01				SHKURT-02				MARS-03				PRILL-04				M A J - 05				QERSHOR - 06				KORRIK - 07				GUSHT - 08				SHTATOR 09				TETOR - 10				NENTOR - 11				DHJETOR - 12			
		I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV								
Drejtorati Regjistrave	Regjistri Elektorik i Fermerëve eFR - regjistrimi i fermerëve	[Green]																																															
	Regjistri Elektorik i Fermerëve eFR - aplikimi për krerë	[Green]																																															
	Regjistri Elektorik i Fermerëve eFR - Administrimi	[Green]																																															
	Regjistri Elektorik i Fermerëve eFR - Bekapi	[Green]																																															
	Sistemi i Identifikimit të Parcelave e Tokës LPIS - aplikimi për sipërfaqe	[Green]																																															
	Sistemi i Identifikimit të Parcelave e Tokës LPIS - Administrimi	[Green]																																															
	Sistemi i Identifikimit të Parcelave e Tokës LPIS - Bekapi	[Green]																																															
	LPIS-MOBILE - Administrimi	[Green]																																															
	Grant Menaxhment - Modulën për aplikim për grante dhe kërkesen për pagesë administrimi	[Green]																																															
	Grant Menaxhment - Modulën për menaxhimin e granteve	[Blue]																																															
	Grant Menaxhment - Modulën për autorizimin e pagesave	[Blue]																																															
	Grant Menaxhment - Modulën për kontroll në terren	[Blue]																																															
	Grant Menaxhment - Me të gjitha modulet bekapi	[Blue]																																															
	Softveri për Menaxhimin e Pagesave Direkte	[Blue]																																															
	Monitorimi dhe mirëmbajtja e Blade enclosure, blade server, MSA storage dhe ultrim tape drive	[Blue]																																															
	Mirëmbajtja e kompjuterëve të AZHB-së duke përfshirë edhe 7 Zyret Regionale	[Dark Green]																																															
	Mirëmbajtja e rrjetit të internetit të AZHB-së duke përfshirë edhe 7 Zyret Regionale	[Dark Green]																																															
	Web faqja - Administrimi dhe publikimi i të dhënave	[Yellow]																																															
Indikator	[Red]																																																

Table 4. Plani i Implementimit për Divizionin e TI & Regjistrave



Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencija za Poljoprivredni Razvoj/
Agency for Agricultural Development

Legjenda e planit të punës 2017

Regjistri Elektorik i Fermereve eFR	
eFR - Forma e aplikimit për aplikim për krer	
Sistemi i Identifikimit të Parcelave e Tokes LPIS	
LPIS-MOBILE	
Grant Menaxhment - Modulin për aplikim për grante dhe kerkesen për pagesë	
Grant Menaxhment - Modulin për menaxhimin e granteve	
Grant Menaxhment - Modulin për autorizimin e pagesave	
Grant Menaxhment - Modulin për kontroll në teren	
Softweri për Menaxhimin e Pagesave Direkte	
Monitorimi dhe mirmbajtja e Blade enclosure, blade server, MSA storage dhe ultrium tape drive	
Mirëmbajtja e kompjutereve të AZHB-së duke përfshir edhe 7 Zyret Regionale	
Mirëmbajtja e rrjetit të internetit të AZHB-së duke përfshir edhe 7 Zyret Regionale	
Web faqja	
Indikatorit	